



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
ANTIKORRUPSIONIN DHE SUNDIMIN E LIGJIT
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”

SHTYLLA II

ANTIKORRUPSIONI

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT

	Fushat tematike	Masat specifike	Afati i realizimit të masave (sipas 3-mujorëve)	Lloji i veprimtarisë së komisionit	Shpeshtësia e veprimtarisë	Institucioni kryesor përgjegjës	Institucione të tjera që duhen përfshirë	Grupe të ndryshme interesi dhe shoqëri civile	Treguesi/t për monitorimin e masës	Rezultatet e pritshme sipas masave
I. Kuadri institucional dhe rregullator për luftën kundër korrupsionit										
I.	Kuadri ligjor dhe institucional	I.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe hartimi i qartë i arkitekturës institucionale mbi bazën e analizës përkatëse.	6-mujori i dytë 2027 e në vijimësi	Veprimtari legjislativ, dëgjesa publike	Vjetore/ periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse), ministria përgjegjëse	Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA), ILDKPKI-ja, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje	Organizata të shoqërisë civile, biznesi, bota akademike, media, grupet e interesit	Kryerja e një analize/vlerësimi të thelluar për nevojën e rishikimit të kuadrit ligjor ekzistues ose miratimit të një ligji të dedikuar për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Hartimi i metodologjisë për montorimin e instrumenteve antikorrupsion.	Përmirësimi i kuadrit rregullues ligjor dhe institucional, forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe garantimi i një qasjeje më efektive dhe të koordinuar në luftën kundër korrupsionit. Përcaktimi me ligj i detyrimit për vlerësimin e riskut të korrupsionit, standardeve të corruption proofing për pozicione në administratë që mbartin risk të lartë korrupsioni. Përcaktimi i qartë i koncepteve mes "korrupsion i vogël" dhe "korrupsion i nivelit të lartë" dhe hartëzimi institucional, duke marrë në konsideratë analizat sektoriale. Rritja e efikasitetit të hetimeve administrative për raste të korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe shmangien e fraksionizimit të kuadrit institucional, monitorimi i masave parandaluese në nivel vendor. Detyrimi për strukturat e posaçme të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Ministrave ose të Kuvendit, që të bashkëlidhin një dokument, i cili vërteton se projektligji i është nënshtruar vlerësimit parandalues të riskut të korrupsionit.
		I.2. Vlerësimi mbi bazën e një analize të thelluar të nevojave për fuqizimin e strukturave për parandalimin e korrupsionit.	6-mujori i dytë 2027 e në vijimësi	Veprimtari legjislativ, dëgjesa publike	1 herë	Kuvendi (komisionet përgjegjëse)	Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, ILDKPKI-ja, MAPA-ja/DPAK-ja	Organizata të shoqërisë civile, biznesi, bota akademike, media, grupet e interesit	Kryerja e një analize/vlerësimi të kornizës ligjore dhe institucionale për parandalimin e korrupsionit, për nevojën e forcimit të strukturave përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit. Miratimi i akteve ligjore të nevojshme për forcimin e strukturave përgjegjëse, për parandalimin e korrupsionit, në varësi të rezultateve të analizës. Numri i dëgjësave me grupet e interesit.	Analizimi i problematikave të arkitekturës institucionale ekzistuese dhe nevojat për ngritjen e një strukture/institucioni të pavarur ose ndryshimin e strukturave ekzistuese për parandalimin e korrupsionit. Sigurimi i pavarësisë dhe funksionimit të efektshëm të strukturave përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit.
		I.3. Vlerësimi i mundësisë për ngritjen e një komisioni të përhershëm ose një nënkomisioni parlamentar në përbërje të Kuvendit, me fokus monitorimin, koordinimin, raportimin, vlerësimin dhe plotësimin e kuadrit institucional për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke marrë si bazë modelet më të mira në vendet e BE-së.	6-mujori i dytë 2025 e në vijimësi	Veprimtari legjislativ	Periodike	Kuvendi	Institucionet raportuese	Organizata të shoqërisë civile, biznesi, bota akademike, media, grupet e interesit	Analizimi i mundësisë së krijimit të një komisioni të përhershëm ose një nënkomisioni parlamentar, sipas modeleve më të mira të vendeve të BE-së.	Forcimi i rolit monitorues dhe mbikëqyrës i Kuvendit në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.
		II. Integriteti publik								
									Miratimi i një ligji të ri "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (6M 2 2025).	
									Hartimi i manualit për konfliktin e interesit që përcakton qartë detyrimet dhe organet përgjegjëse (3 muaj pas miratimit të ligjit).	
									Krijimi i një regjistri në nivel qendror dhe vendor për identifikimin e rasteve të shkeljeve të konfliktit të interesave nga zyrtarët publik dhe sanksioni i zbatuar (3 M 1 2026).	

	Fushat tematike	Masat specifike	Afati i realizimit të masave (sipas 3-mujorëve)	Lloji i veprimtarisë së komisionit	Shpeshtësia e veprimtarisë	Institucioni kryesor përgjegjës	Institucione të tjera që duhen përfshirë	Grupe të ndryshme interesi dhe shoqëri civile	Treguesi/t për monitorimin e masës	Rezultatet e pritshme sipas masave
II.	Konflikti i interesit, lobimi dhe sinjalizimi i rasteve të korrupsionit	II.1. Përmirësimi i kuadrit rregullator për konfliktin e interesit.	6-mujori i dytë 2025 e në vijimësi	Veprimtari legjislativë, veprimtari monitoruese	Vjetore/periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse), MAPA-ja, ILDKPKI-ja	Departamenti i Administratës Pubike (DAP)	Organizatrat ndërkombëtare, bota akademike, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e interesit, ekspertë	Miratimi i një metodologjie të përcaktuar për mënyrën e raportimit dhe mbledhjes së të dhënave për rastet e veprimit në kushtet e konfliktit të interesit (3 M 2 2026). Miratimi i udhëzimeve specifike për çështjet e integritetit, të përshtatura për kategori të ndryshme që janë më të ekspozuara ndaj riskut të korrupsionit, të cilat duhet të rishikohen dhe plotësohen rregullisht (3 M 3 2026). Zhvillimi i paketave të integritetit për stafin e ri dhe veçanërisht për stafin që merr detyra në sektorët me risk të lartë (3 M 2 2026).	Norma të reja më të qarta dhe të përqasura me standardet e BE-së që rregullojnë konfliktin e interesit. Qartësi dhe kuptueshmëri e ligjit; përgatitja dhe publikimi i statistikave të detajuara nga ILDKPKI-ja mbi përputhshmërinë me detyrimet, ndalimet dhe kufizimet e lidhura me menaxhimin e konfliktit të interesit, duke përfshirë edhe pavlefshmërinë e kontratave të lidhura në kushtet e konfliktit të interesit. Kufizimet e pas punësimit për zyrtarët e zgjedhur vendorë dhe kategori të tjera zyrtarësh që janë subjekte të ligjit; mekanizëm i përshtatshëm zbatues për kufizimet e pas punësimit; rritja e efikasitetit të ILDKPKI-së dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse përmes përcaktimit të saktë të fushës së përgjegjësisë së tyre, si dhe mbajtja e një historiku të plotë të subjekteve të ligjit dhe shkeljet e kryera.
		II.2. Identifikimi në kohë reale i situatave të mundshme të konfliktit të interesit përmes analizës automatike të të dhënave	1-mujori i katërt 2025	Veprimtari monitoruese	Vjetore/periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse), ILDKPKI-ja, AKSHI	MAPA-ja	Organizatrat ndërkombëtare, bota akademike, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e interesit, ekspertë	Krijimi i një platformë digjitale, e cila do të mundësojë identifikimin në kohë reale të situatave të mundshme të konfliktit të interesit përmes analizës automatike të të dhënave. Numri i rasteve të identifikuara të konfliktit të interesit në kohë reale.	Rritja e efikasitetit në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të konfliktit të interesit përmes përdorimit të platformës. Forcimi i besimit të publikut dhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve.
		II.3. Përmirësimi i kuadrit rregullator për etikën për deputetët, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe këshilltarët politikë.	2026	Veprimtari rregullator/monitorues e	1 herë/periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse; Byroja e Kuvendit); Këshilli i Ministrave	Këshilli i Ministrave, MAPA-ja	Bota akademike, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e biznesit	Amendimi i Kodit të Sjelljes së Deputetëve. Rishikimi i përkufizimit mbi "konfliktin e interesit" në Kodin e Sjelljes së Deputetëve. Krijimi i një komiteti këshillimor për rastet e trajtimit të konfliktit të interesit.	Për Kodin e Sjelljes së Deputetëve: sistem i qartë dhe transparent i sanksioneve (që mund të jenë pezullim, gjoba apo qortim publik); krijimi i një strukture për të interpretuar dhe zbatuar Kodin e Sjelljes së Deputetëve me funksione këshillimore dhe zbatuese; krijimi i një trupe të pavarur të etikës për verifikimin e deklaratave mbi dhuratat. Në lidhje me Kodin Etik Ministror (KEM), do të ketë kufizime më të qarta pas punësimit për anëtarët e Këshillit të Ministrave, duke përfshirë edhe lobimin; përcaktimin e kufizimeve të paspunësimit për këshilltarët politikë; mekanizma të përshtatshëm për zbatimin efektiv të KEM-së, duke zgjeruar përbërjen e Komisionit të Etikës në përbërje të të cilit mund të përfshihen ish-zyrtarë të lartë me integritet.
		II.4. Rregullimi i veprimtarisë së lobimit.	2026	Veprimtari legjislativë, dëgjesa publike	1 herë/periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse), MAPA-ja	Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë	Bota akademike, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e biznesit	Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për lobimin". Numri tryezave me shoqërinë civile, median, botën akademike. Krijimi i një sistemi për të dokumentuar të gjitha palët e interesuara që llojnë ose ndikojnë në proceset vendimmarrëse.	Identifikimi i rasteve që llojnë ose ndikojnë në proceset vendimmarrëse; përmirësimi i llogaridhënies së institucioneve publike dhe rritja e besimit të qytetarëve, e cila do të sjellë përmirësim në sistemin elektronik (regjistrat të transparencës me grupet e lobimit), ku deputetët duhet të dokumentojnë të gjitha inputet e jashtme të marra gjatë procesit legjislativ; rritja e transparencës mbi mënyrën se si lobistët dhe grupet e interesit ndikojnë legjislacionin, (koncept i njohur si "gjurma legjislativë").
		II.5. Vlerësimi i nevojës për rishikimin e ligjit nr. 60/2015 datë 2.6.2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar.	6-mujori i dytë 2027	Veprimtari legjislativë, dëgjesa publike	1 herë	Kuvendi (komisionet përgjegjëse), Ministria e Drejtësisë	Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, MAPA-ja, ILDKPKI-ja	Shoqëria civile, biznesi, bota akademike, media	Kryerja e një analize për nevojën e rishikimit të ligjit nr. 60/2016 dhe miratimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore, në varësi të rezultateve të analizës. Numri i tryezave të konsultimit.	

	Fushat tematike	Masat specifike	Afati i realizimit të masave (sipas 3-mujorëve)	Lloji i veprimtarisë së komisionit	Shpeshtësia e veprimtarisë	Institucioni kryesor përgjegjës	Institucione të tjera që duhen përfshirë	Grupe të ndryshme interesi dhe shoqëri civile	Treguesi/t për monitorimin e masës	Rezultatet e pritshme sipas masave
		II.6. Fuqizimi i strukturave mbështetëse të dedikuara për mundësimin e këshillimit dhe mbështetjes për sinjalizuesit.	6-mujori i dytë 2027	Veprimtari legjislativ, Dëgjesa publike	Vjetore/ periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse)	Institucionet përgjegjëse/ Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave	Shoqëria civile, biznesi, bota akademike, media, institucionet e pavarura	Miratimi i strukturës mbështetëse me ligj.	Përmirësimi, forcimi dhe përafrimi i legjisllacionit me qëllim fuqizimin e mekanizmave ku bëhet raportimi dhe sigurimi i mbrojtjes më të qartë ligjore.
		II.7. Forcimi i sinjalizimit të brendshëm.	Në vijimësi	Veprimtari monitoruese	Vjetore/ periodike	Kuvendi (komisioni përgjegjës), institucioni përgjegjës	Autoritete publike qendrore/vendore	Shoqëria civile, biznesi, bota akademike, media, subjekte private	Numri i raporteve të strukturës përgjegjëse.	
									Krijimi i një platforme raportuese pranë NjP.	
		II.8. Forcimi i kapaciteteve dhe rritja e informimit dhe ndërgjegjësimit për punonjësit e njësive përgjegjëse për sinjalizimin dhe publikun e gjerë	Në vijimësi	Veprimtari monitoruese	Vjetore/ periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse), institucioni përgjegjës	ASPA, njësitë përgjegjëse sipas ligjit	Shoqëria Civile, biznesi, bota akademike, media	Numri i fushatave dhe aktiviteteve informuese ose ndërgjegjësuere.	
									Numri i trajnimeve/kurrikulave vazhduese për njësitë përgjegjëse për sinjalizimin dhe ILDKPKI-në	
									Nr i studimeve të dedikuara	
II.9. Krijimi i një sistemi efektiv dhe të besueshëm për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.	3-mujori i katërt 2027	Veprimtari monitoruese	Vjetore/ periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse)	Kryeministria, Ministria përgjegjëse për Financat, ILDKPKI-ja, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)	Organizata të shoqërisë civile, grupet e biznesit	Numri i sinjalizuesve të mbrojtur nga hakmarrja apo ndëshkimi përmes mekanizmave të parashikuar.			
							Numri i personave/ njësive të informuara.			
II.10. Fuqizimi i rolit të ILDKPKI-së në verifikimin e pasurisë së zyrtarëve; rritja e eficientës, transparencës dhe llogaridhënies.	2027 e në vijimësi	Veprimtari legjislativ, veprimtari monitoruese	Periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse), ILDKPKI-ja		Shoqëria civile, biznesi, bota akademike, media	Vlerësimi i nevojave për ndryshimin e ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.			
							Sigurimi i burimeve të qëndrueshme dhe kapaciteteve për ILDKPKI-në për të kryer verifikime efikase (proaktive) të deklaratave të pasurisë.			
III. Financimi politik										
III.	Financimi i partive politike.	III.1. Ndërhyrje në kuadrin ligjor zgjedhor për përcaktimin e detyrimeve të "palëve të treta".	3-mujori i katërt 2025	Veprimtari legjislativ, dëgjesa publike me grupet e interesit: partitë politike, median etj.	Vjetore	Kuvendi, KQZ-ja/ partitë politike		Bota akademike, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e biznesit	Amendim i Kodit Zgjedhor	Miratimi i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor mbi: përcaktimin e detyrimeve të "palëve të treta" që përfshihen në fushatë; vendosjen e rregullave mbi parandalimin e burimeve të fshehta të financimit; mbi mbulimin mediatik të padeklaruar të partive politike dhe kandidatëve/subjekteve zgjedhor; mbi përcaktimin e të gjitha formave të mbështetjes financiare apo mediatike.
									Numri i tryezave me shoqërinë civile; botën akademike.	
		III.2. Rregullimi i fushatave të palëve të treta dhe reklamave digjitale	3-mujori i parë 2027	Miratimi rregulloresh, veprimtari monitoruese	Periodik	Kuvendi, KQZ-ja/ partitë politike		Bota akademike, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e biznesit	Miratimi i rregullores	Miratimi i rregulloreve për fushatat e aktorëve jogarues dhe reklamën digjitale, duke siguruar transparencën dhe moskufizimin e panevojshëm të lirisë së shprehjes.
									Raporti Monitorues	
		III.3. Rritja e Transparencës dhe roli i medias	6-mujori i 1-të 2025	Veprimtari monitoruese	Periodik	Kuvendi, KQZ-ja		Bota akademike, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e biznesit	Standartizim i termit "dhënie fondi"	Termi "dhënie fondi" duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që të përfshijë të gjitha format e mbështetjes financiare apo mediatike.
									Raporti Monitorues	
		III.4. Auditimi i partive politike.	6-mujori i dytë 2025	Veprimtari monitoruese	Periodik	Kuvendi, KQZ-ja		Bota akademike, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e biznesit	Miratimi i procedurave të reja të auditimit	Rritja e transparencës së financimit të partive politike.
									Publikimi i informacionit financiar nga partitë	

	Fushat tematike	Masat specifike	Afati i realizimit të masave (sipas 3-mujorëve)	Lloji i veprimtarisë së komisionit	Shpeshtësia e veprimtarisë	Institucioni kryesor përgjegjës	Institucione të tjera që duhen përfshirë	Grupe të ndryshme interesi dhe shoqëri civile	Treguesi/t për monitorimin e masës	Rezultatet e pritshme sipas masave
		III.5. "Miratimi i një ligji të posaçëm "Për financimin e partive politike".	2025	Veprimtari legjislativ, dëgjesa publike me grupet e interesit: partitë politike,	1 herë	Kuvendi, KQZ-ja	MAPA-ja	Bota akademike, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e biznesit	Miratimi i ligjit	Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies. Përmirësimi i mekanizmave të mbikëqyrjes së financimeve të partive politike dhe të fushatave. Parashikimi rregullimeve lidhur me transaksionet me kriptomonedha, financimin e huaj, etj. Kuatër ligjor në përputhje me standardet europiane dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias /GRECO-s dhe OSBE/ODHIR-it.
IV. Kontrolli financiar dhe menaxhimi i financave publike										
IV.	Kontrolli financiar dhe inspektimi financiar publik.	IV.1. Përmirësimi i pavarësisë së Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar.	3-mujori i katërt 2027	Veprimtari legjislativ, dëgjesa publike	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore), Ministria e Financave	Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë	Shoqëria civile, organizatat e biznesit, institucione e pavarura	Kryerja e një analize të thelluar për zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, të ndryshuar. Miratimi i ndryshimeve ligjore të nevojshme, në varësi të rezultateve të analizës.	Përmirësimi i pavarësisë së Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar nëpërmjet: i) ndryshimit të përbërjes së tij dhe sigurimit të një përbërje gjithëpërfshirëse (përfaqësues nga shoqëria civile, institucione të pavarura të fushës, etj); ii) rritjes së përgjegjshmërisë manaxheriale në lidhje me vendimmarrjen; (iii) proces emërimi i qartë dhe transparent.
		IV.2. Forcimi i pavarësisë funksionale të njëjësive të auditit të brendshëm.	3-mujori i katërt 2027	Veprimtari legjislativ, dëgjesa publike	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore), Ministria e Financave	Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë	Organizatave të biznesit, institucionet e pavarura	Kryerja e një analize të thelluar për zbatimin e ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar. Miratimi i ndryshimeve ligjore të nevojshme, në varësi të rezultateve të analizës.	Forcimi i pavarësisë funksionale të njëjësive të auditit të brendshëm.
		IV.3. Ndryshimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 160, datë 2.3.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike"	3-mujori i katërt 2025	Veprimtari legjislativ, dëgjesa publike, veprimtari monitoruese	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore), Ministria e Financave	Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë	Grupet e interesit	Miratimi i ndryshimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 160/2016 .	Forcimi i pozitës, kompetencave dhe mënyrës së emërimit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm duke synuar rritjen e efektivitetit të auditimit të brendshëm dhe zbatimit të rekomandimeve, shmangien e konflikt të interesit dhe forcimin e pavarësisë funksionale.
		IV.4. Përditësimi i manualit të auditimit të brendshëm dhe kodit të etikës.	3-mujori i katërt 2025	Veprimtari rregulluese, veprimtari monitoruese	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore), Ministria e Financave	Njësitë e auditimit të brendshëm	Grupet e interesit	Miratimi i përditësimeve në manualin e auditimit të brendshëm.	Rritja e efikasitetit dhe pavarësisë së veprimtarisë së auditit të brendshëm në institucione.
		IV.5. Sigurimi i shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësitë publike.	3-mujori i katërt 2026	Veprimtari monitoruese	Vjetore/ periodike	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Nënkomisioni përgjegjës për Auditimin), Ministria e Financave	Njësitë e auditimit të brendshëm dhe njësitë e sektorit publik, përfshirë qeverisjen e përgjithshme, organet e vetqeverisjes vendore dhe shoqëritë publike/ndërmarrjet shtetërore	Grupet e interesit	Numri i njëjësive të AB-ve të ngritura; Numri marrëveshjeve të lidhura ndërmjet njëjësive publike; Numri i kontratave të shërbimit të AB-ve; Numri i raporteve të auditimit.	Rritja e kapaciteteve dhe efikasitetit në lidhje me veprimtaritë e këtyre njëjësive në institucionet e qeverisjes vendore. Rritja e monitorimit nga Kuvendi.
		IV.6. Rritja e transparencës së menaxhimit të fondeve publike.	3-mujori i katërt 2025	Veprimtari monitoruese	Vjetore/ periodike	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Nënkomisioni përgjegjës për Auditimin), Ministria e Financave	Njësitë e auditimit, titullarët e njëjësive publike	Grupet e interesit	Numri i raporteve përmbledhëse të auditimit	Rritja e transparencës dhe publikimi i raporteve përmbledhëse vjetore të auditimit të brendshëm nga çdo njësi dhe sidomos nga organet e pushtetit vendor dhe shoqëritë tregtare që i nënshtrohen këtij detyrimi. Rritja e monitorimit të Kuvendit në procesin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve në raportet e NJAB-të.
									Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm Profesional i miratuar; Numri i audituesve të brendshëm të certifikuar (skema kombëtare dhe ndërkombëtare);	

	Fushat tematike	Masat specifike	Afati i realizimit të masave (sipas 3-mujorëve)	Lloji i veprimtarisë së komisionit	Shpeshhtësia e veprimtarisë	Institucioni kryesor përgjegjës	Institucione të tjera që duhen përfshirë	Grupe të ndryshme interesi dhe shoqëri civile	Treguesi/t për monitorimin e masës	Rezultatet e pritshme sipas masave
		IV.7. Forcimi i kapaciteteve dhe zhvillimi i aftësive profesionale nëpërmjet edukimit të vijueshëm të audituesve publik.	Në vijimësi	Veprimtari monitoruese	Periodike/ Vjetore	Kuvendi (komisionet përgjegjëse), Ministria e Financave	Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, titullarët e njësive publike dhe njësitë e auditimit në sektorin publik	Grupet e interesit	Numri i audituesve të brendshëm të trajnuar sipas Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm.	Rritja e numrit të audituesve publik të certifikuar. Edukimi i vijueshëm konform standardeve ndërkombëtare. Angazhimi i ekspertëve të jashtëm edhe në fushën e auditimit të njësive publike, kundrejt kriterëve të përcaktuara me akt ligjor ose nënligjor. Për çështje që lidhen me auditimin e njësive publike, të cilat kanë nevojë për ekspertizë të posaçme, kontraktimi dhe angazhimi i ekspertëve të jashtëm duhet jo vetëm të parashikohet nga këto ligje, por të jetë i detyrueshëm me ligj
		IV.8. Përmirësimi i vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 70, datë 25.7.2024 "Për Ngritjen e Nënkomisionit "Për Auditimin e Sektorit Publik", bazuar në vlerësimin e kryer.	3-mujori i katërt 2026	Veprimtari legjislativ, dëgjesa publike	1 herë	Kuvendi, KLSH-ja		Organizatat e biznesit, institucionet e pavarura	Kryerja e një analize për të nevojën e ndryshimit të vendimit të Kuvendit nr. 70/2024.	Forcimi i kapacitetit monitorues të Kuvendit ndaj KLSH-së me qëllim rritjen e transparencën dhe llogaridhënies.
		IV.9. Vlerësimi i nevojave për ndryshimin e ligjit nr. 112/2015 "Për inspektimin financiar publik" dhe/ose të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 84, datë 3.2.2016 "Për procedurat e përgjeshdhjes dhe të shpërbllimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik.	3-mujori i katërt 2027	Veprimtari legjislativ, dëgjesa publike	1 herë	Ministria e Financave, Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore)	Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë	Organizatat e biznesit, institucione e pavarura	Numri i raportimeve	Rritja e përgjegjshmërisë së titullarëve të njësive publike lidhur me vendosjen në dispozicion të ekspertëve të jashtëm.
		IV.10. Vlerësimi i nevojave për ndryshimin e kuadrit ligjor të funksionimit të KLSH-së, bazuar në analizë të thelluar në këtë fushë me ekspertizë ndërkombëtare.	3-mujori i katërt 2026	Veprimtari legjislativ. dëgjesa publike	1 herë	Kuvendi	KLSH-ja	Grupet e interesit	Kryerja e një analize të thelluar dhe marrja e masave përkatëse, në varësi të rezultateve të analizës.	Rritja e efikasitetit dhe eficiencës së auditimit të jashtëm, sipas praktikave/modeleve më të mira europiane dhe ndërkombëtare. Rritja e efikasitetit dhe parandalimit të rasteve të korrupsionit. Rritja e cilësisë dhe e zbatueshmërisë së rekomandimeve të auditimit të jashtëm.
V. Rregullimi i tregut dhe konkurrueshmëria										
		V.1. Forcimi i integritetit institucional nga bankat e nivelit të dytë.	3-mujori i dytë 2026	Veprimtari monitoruese	Vjetore/ Periodike	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat), Banka e Shqipërisë		OJF-të, media, grupet e biznesit, bota akademike, shoqata e bankave	Miratimi i rregulloreve nga Banka e Shqipërisë. Raportimi vjetor i Bankës së Shqipërisë në Kuvend.	Përmirësimi i transparencës mbi adresimin e shqetësimeve, mbi konfliktin e Interesit dhe organizimin e brendshëm të bankave; publikimi i kodeve të drejtimit të brendshëm, rregulloreve të konfliktit të interesit dhe programeve të përputhshmërisë antikorrsion, të cilat duhet të paraprihen nga vlerësimi i risikut të korrupsionit. Përmirësimi dhe standardizimi i kodeve të etikës
		V.2. Forcimi i integritetit institucional të subjekteve nën mbikëqyrje.	3-mujori i dytë 2026	Veprimtari monitoruese	Periodike/Vjetore	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat), Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)		OJF-të, media, grupet e biznesit, bota akademike	Miratimi i rregulloreve nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Raportimi vjetor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Kuvend.	Përmirësimi i transparencës mbi adresimin e shqetësimeve mbi konfliktin e Interesit dhe organizimin e brendshëm të shoqërive të sigurimit, publikimi i kodeve të drejtimit të brendshëm, rregulloreve të konfliktit të interesit dhe programeve të përputhshmërisë antikorrsion, të cilat duhet të paraprihen nga vlerësimi i risikut të korrupsionit. Përmirësimi dhe standardizimi i kodeve të etikës.

	Fushat tematike	Masat specifike	Afati i realizimit të masave (sipas 3-mujorëve)	Lloji i veprimtarisë së komisionit	Shpeshtësia e veprimtarisë	Institucioni kryesor përgjegjës	Institucione të tjera që duhen përfshirë	Grupe të ndryshme interesi dhe shoqëri civile	Treguesi/t për monitorimin e masës	Rezultatet e pritshme sipas masave
V.	Rregullimi i tregut, mbikëqyrja dhe konkurreueshmëria.	V.3. Përmirësimi i kuadrin ligjor për marrëveshjet në prokurime.	3-mujori i katërt 2026	Veprimtari legjislative, dëgjese publike	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat), Ministria e Financës	Autoriteti i Konkurrencës, APP-ja	OJF-të, media, shoqatat e biznesit	Vlerësimi i nevojave për ndryshime të mundshme në ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës". Vlerësimi i mundësisë së krijimit të një mekanizmi stimulues për operatorët ekonomikë përmes certifikatës së ligjshmërisë, duke u bazuar në modelin e AGCM-së italiane.	Ndalimi i marrëveshjeve midis ofruesve në garat e prokurimit.
		V.4. Përmirësimi i pavarësisë operacionale të Komisionit të Ndhmës Shtetërore.	3-mujori i parë 2027	Veprimtari legjislative, dëgjese publike	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore)	AK-ja, Ministria e Financave, MEKI	OJF-të, media, grupet e biznesit, bota akademike	Amendim i ligjit nr. 9374/2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar. Numri i tryezave me shoqërinë civile; median, botën akademike.	Garantimi i pavarësisë operacionale të Komisionit të Ndhmës Shtetërore, duke siguruar eficientë dhe transparencë në procesin e akordimit të ndihmës shtetërore.
		V.5. Forcimi i treguesve të integritetit në procesin e përzgjedhjes për nivelin e lartë drejtues të autoriteteve mbikëqyrëse të analizuarra më sipër (Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AK-ja, AKEP-i) si institucioneve me rol të rëndësishëm në treg.	3-mujori i katërt 2026 e në vijimësi	Veprimtari legjislative, dëgjese publike	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Tregtinë, Komisioni përgjegjës për Çështjet Europiane)	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Banka e Shqipërisë, AKEP-i	OJF-të, media, grupet e biznesit, bota akademike	Vlerësimi i nevojave për ndryshime ligjore: ligji "Për Bankën e Shqipërisë", ligji "Për mbrojtjen e konkurrencës", ligji "Për komunikimet elektronike ", ligji "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare". Miratimi i ndryshimeve ligjore të nevojshme. Përcaktimi i rregullave të para dhe pas punësimit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë, si dhe anëtarët e këshillit drejtues të AKEP-it (kufizime pas punësimit për këtë kategori). Numri i tryezave me shoqërinë civile; median, botën akademike.	Kontrolli i pastërtisë së figurës (realizimi i shqyrtimit të thelluar të integritetit), profesionalizëm dhe integritet i anëtarëve të organeve drejtuese. Përmirësimi dhe adresimi i konfliktit të interesit dhe revolving door nga institucionet mbikëqyrëse.
		V.6. Parandalimi i korrupsionit përmes hartimit të instrumenteve të integritetit nga autoritetet mbikëqyrëse në treg.	3-mujori i katërt 2026	Veprimtari monitoruese	Periodike	MAPA, Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Tregtinë)	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Banka e Shqipërisë, AKEP-i	OJF-të, media, grupet e biznesit, bota akademike	Hartimi dhe zbatimi i instrumenteve antikorrupsion nga Banka e Shqipërisë, AMF-ja, AKEP-i, AK-ja. Raportimi vjetor dhe numri i instrumenteve antikorrupsion të hartuara.	Parandalimi i korrupsionit dhe forcimi i integritetit institucional.

	Fushat tematike	Masat specifike	Afati i realizimit të masave (sipas 3-mujorëve)	Lloji i veprimtarisë së komisionit	Shpeshtësia e veprimtarisë	Institucioni kryesor përgjegjës	Institucione të tjera që duhen përfshirë	Grupe të ndryshme interesi dhe shoqëri civile	Treguesi/t për monitorimin e masës	Rezultatet e pritshme sipas masave
		V.7. Zgjerimi i subjekteve që vendosin dhe zbatojnë kornizën/kuadrin e kontrollit të brendshëm dhe përcaktimi i detyrimit për realizimin e auditimit të brendshëm.	3-mujori i tretë 2027	Veprimtari legjislativ, dëgjësë publike	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Çështjet ligjore, Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe financat, Komisioni përgjegjës për Tregtinë, Komisioni përgjegjës për Çështjet Europiane)	MEKI, Ministria e Financave	OJF-të, media, grupet e biznesit, bota akademike	Miratimi i ndryshimit të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe ndryshimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 16.1.2019.	Vendosja dhe zbatimi i kornizës/kuadrit të kontrollit të brendshëm nga të gjitha NJEIP-të (edhe ato që bien jashtë kategorive të bankave dhe shoqërive të sigurimit), si dhe përcaktimi i detyrimit ligjor për realizimin auditit të brendshëm në mënyrë të detyrueshme nga të gjitha njësitë ekonomike me interes publik, duke forcur standardet e administrimit dhe me anë të riskut operacional, reputacional dhe të korrupsionit. Zgjerimi i detyrimit për auditimin e brendshëm edhe te subjektet e ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
		Numri i tryezave me shoqërinë civile; media, botën akademike .								
		V.8. Forcimi i integritetit ne sektorin privat.	6-mujori i 2-të 2027	Veprimtari legjislativ, dëgjësë publike	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat)	MEKI	Shoqatat e biznesit, OJF-të, etj	Hartimi i instrumenteve antikorruption për sektorin privat.	Parandalimi i korrupsionit dhe forcimi i praktikave të integritetit në sektorin privat. Identifikimi i subjekteve që përfshihen në praktika korruptive dhe forcimi i qëndrueshmërisë së subjekteve private ndaj korrupsionit. Monitorim më i mirë i përputhshmërisë me instrumentet antikorruption.
		Numri i tryezave me shoqërinë civile; median, botën akademike.								
		V.9. Miratimin e konventës së OECD-së "Për luftën kundër rryshfetit të zyrtarëve publikë të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar".	3-mujori i katërt 2027	Veprimtari legjislativ, dëgjësë publike	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Tregtinë, Komisioni përgjegjës për Çështjet Europiane)	Ministria e Drejtësisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Shoqatat e biznesit, OJF-të etj	Miratim i ligjit ratifikues.	Ratifikimi i instrumentit ndërkombëtar në luftën ndaj rryshfetit të zyrtarëve të lartë. Shfrytëzimi i mekanizmave të monitorimit të saj për të siguruar zbatim gjithëpërfshirës të detyrimeve ndërkombëtare.
	Numri i tryezave me shoqërinë civile; median, botën akademike.									
	V.10. Transpozimin e Direktivës Due Diligence për Qëndrueshmërinë e Korporatës (Corporate Sustainability Due Diligence Directive)	3-mujori i katërt 2027	Veprimtari legjislativ, dëgjësë publike	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Tregtinë, Komisioni përgjegjës për Çështjet Europiane)	MEKI	Shoqatat e biznesit, OJF-të etj	Transpozimi i direktivës në kuadrin ligjor.	Përmirësimi i integritetit të organizatave tregtare (detyrimi për raportimin për respektimin e të drejtave të njeriut në përputhje me parashikimet e direktivës).	
	Numri i tryezave me shoqërinë civile; median, botën akademike.									
	V.11. Rritja e Integritetit dhe transparencës në inspektoriate.	3-mujori i katërt 2027	Veprimtari legjislativ, veprimtari monitoruese, dëgjësja publike	Vjetore/periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse), Këshilli i Ministrave	Inspektorati i Përgjithshëm (Qendror)	Shoqëri civile, bota akademike dhe shoqatat e biznesit	Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për funksionimin dhe organizimin e IP-ve, ku të detajohen burimet e tjera të ligjshme të financimit.	Pasurimi i programeve të trajnimit vazhdues me fokus të veçantë praktikant antikorruption dhe integritetin; Parandalimi i praktikave korruptive nëpërmjet miratimit të planeve të integritetit për secilin inspektorat dhe unifikimit të tyre; Zgjerimi i mëtejshëm i platformës digjitale, kalimi në sistem online i procedurave të inspektimit, dhe përmirësimi i platformës akuale të inspektimeve online.	
	Rritja e numrit të trajnimeve të inspektorëve lidhur me inspektimet në terren.									
Numri i planeve të integritetit të miratuara.										
Rritja e numrit të procedurave të inspektimit online, rritja e numrit të të dhënave dhe informacionit mbi inspektimet dhe masat e marra.										

Fushat tematike	Masat specifike	Afati i realizimit të masave (sipas 3-mujorëve)	Lloji i veprimtarisë së komisionit	Shpeshtësia e veprimtarisë	Institucioni kryesor përgjegjës	Institucione të tjera që duhen përfshirë	Grupe të ndryshme interesi dhe shoqëri civile	Treguesi/t për monitorimin e masës	Rezultatet e pritshme sipas masave
VI. Funksionet e qeverisjes dhe sektorët me risk të lartë korrupsioni									
Masa të përgjithshme	VI.1. Vlerësimi i risqeve të korrupsionit në sektorët me risk të lartë, si tatimet, doganat, pronat, arsimi, shëndetësia, prokurimet publike dhe koncesionet/PPP-të, etj.	3-mujori i katërt 2026	Veprimtari monitoruese, dëgjesa, raportim i ministrit, institucionit përgjegjës sipas fushës së veprimtarisë	Vjetore / periodike	Kuvendi (komisionet përgjegjëse)		Organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, grupet e biznesit, bota akademike, ekspertë	Miratimi i metodologjisë së vlerësimit të riskut pas konsultimit me institucionet dhe grupet e interesit. Hartimi dhe miratimi i një plani veprimi për parandalimin e korrupsionit në këto sektore. Hartimi i programit të trajnimit sipas sektorëve. Programi i trajnimit përfshin modulën mbi integritetin, forcimin e kapaciteteve për vlerësimin e risqeve dhe hartimin e zbatimit të masave kundër korrupsionit në planin e masave. Numri i punonjësve të trajnuar, duke përfshirë stafin e angazhuar në vlerësimin e risqeve të korrupsionit dhe hartimin e planeve të masave.	Identifikimi dhe reduktimi i risqeve të korrupsionit në sektorët me risk të lartë ndaj korrupsionit, përmes zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit. Përmirësimi i aftësive profesionale dhe etike të punonjësve të administratës publike në sektorët me risk të lartë, duke forcuar kapacitetet institucionale për integritet dhe minimizuar hapësirat për korrupsion.
	VI.2. Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies në sektoret me risk të lartë ndaj korrupsionit.	Në vijimje	Veprimtari monitoruese	Vjetore / periodike	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Shëndetësinë, Komisioni përgjegjës për Edukimin)	Kryeministria, ministri përgjegjës për Financat, ministri përgjegjës për Ekonominë, AKSHI, ministri përgjegjës për Shëndetësinë, ministri përgjegjës për Arsimin, ASHK-ja, DPT-ja, DPD-ja, Agjenca e Prokurimit Publik, Njësia e Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private.	Organizata ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile, grupet e biznesit	Vlerësimi i nevojave për përmirësim, i hartuar dhe konsultuar gjerësisht në të gjithë sektorët me risk të lartë. Përqindja e institucioneve në sektorët me risk të lartë që kanë zbatuar masat për përmirësim, të identifikuar. Numri i institucioneve shëndetësore që publikojnë planifikime të detajuara buxhetore dhe raportet financiare vjetore online. Raport vjetor i APP me të dhëna të plota për zbatimin e kontratave. Raportimet mbi koncesionet/PPP-të përmbajnë të dhëna të plota dhe gjithëpërfshirëse.	Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies në sektorët me risk të lartë, përmes raportimit të plotë, publikimit të të dhënave dhe aksesit të zgjeruar në informacion.
Policia e Shtetit	VI.3. Forcimi i integritetit në Policinë e Shtetit	3-mujori i tretë 2026	Veprimtari monitoruese	Vjetore / periodike	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare)	Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit	OJF-të, grupe interesi	Hartimi i instrumenteve antikorrupsion. Numri i raporteve monitoruese, i instrumenteve antikorrupsion.	Përmirësimi i integritetit institucional dhe transparencës në Policinë e Shtetit.
	VI.4. Rritja e transparencës dhe diferencimi i burimeve të donacioneve.	3-mujori i katërt 2026	Veprimtari monitoruese	Vjetore / periodik	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare, Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Nënkomisioni përgjegjës për Auditimin e Sektorit Publik)	Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit	OJF-të, grupe interesi, bota akademike, etj.	Ndryshimi i urdhrat të drejtorit të Policisë së Shtetit. Raportim i detajuar financiar dhe etik mbi veprimtarinë e Policisë së Shtetit Raport i auditimit të jashtëm i Policisë së Shtetit.	Diferencimi i burimeve në donacione dhe kritere të qarta për klasifikimin e tyre.
	VI.5. Përmirësimi i kuadrit rregullator mbi shërbimet shtesë të ofruara nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesave.	3-mujori i katërt 2026	Veprimtari legjislativ	1 herë	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare)	Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit	OJF-të, grupe interesi	Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave dhe rregullores përkatëse.	Shmangia e konfliktit të interesit nëpërmjet shërbimeve të ofruara me pagesë.
	VI.6. Përmirësimi i kapaciteteve hetimore të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP) për trajtimin efektiv të ankesave dhe rasteve të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës.	3-mujori i katërt 2027	Veprimtari monitoruese	Vjetore/periodike	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare, Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat)	Ministria e Brendshme, AMP-ja, Ministria përgjegjëse për Financat	Organizata të shoqërisë civile, grupe interesi	Përqindja e buxhetit të parashikuar në raport me koston e vlerësuar, si të nevojshme për zbatimin e masës. Përqindja e rasteve të hetuara duke përdorur teknika speciale dhe mjete të avancuara të hetimit. Shkalla e përmirësimit të infrastrukturës logjistike dhe teknologjike.	Rritja e efektivitetit të hetimeve për korrupsion dhe shpërdorim detyrë përmes përdorimit të teknikave speciale dhe mjeteve të avancuara; Modernizimi i infrastrukturës teknologjike dhe logjistike për përmirësimin e analizës së të dhënave dhe trajtimit të ankesave.

	Fushat tematike	Masat specifike	Afati i realizimit të masave (sipas 3-mujorëve)	Lloji i veprimtarisë së komisionit	Shpeshtësia e veprimtarisë	Institucioni kryesor përgjegjës	Institucione të tjera që duhen përfshirë	Grupe të ndryshme interesi dhe shoqëri civile	Treguesi/t për monitorimin e masës	Rezultatet e pritshme sipas masave
Administrata doganore		VI.13. Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe edukuese për qytetarët mbi rëndësinë e përbushjes së detyrimeve tatimore dhe ndikimin negativ të korrupsionit.	Në vazhdimësi	Veprimtari monitoruese, dëgjesa publike me qytetarët dhe diskutime me institucionet e qeverisjes qendrore	Vjetore/ periodike	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat) Ministri përgjegjës për Financat	DPT-ja	Organizata ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile, grupet e biznesit, bota akademike, ekspertë	Numri i fushatave ndërgjegjësuere të zhvilluara për qytetarët. Numri i qytetarëve të informuar për rëndësinë e përbushjes së detyrimeve tatimore. Numri i mjeteve inovative të përdorura nga administrata tatimore për ndërgjegjësimin dhe edukimin e qytetarëve (p.sh., pop-up njoftime, chatbot me AI, aplikacione mobile, video edukuese interaktive, etj).	Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi rëndësinë e përbushjes së detyrimeve tatimore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcur besimin në administratën tatimore dhe promovuar sjellje të përgjegjshme financiare.
		VI.14. Sigurimi i një numri të mjaftueshëm punonjësish të kualifikuar dhe të trajnuar në administratën tatimore dhe doganore për të përmirësuar efikasitetin dhe ulur mundësitë për korrupsion.	3-mujori i katërt 2027	Veprimtari monitoruese	Vjetore/ periodike	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat), DPT-ja, DPD-ja	Ministria përgjegjëse për Financat, DAP-ja, ASPA	Organizata të shoqërisë civile	Përqindja e buxhetit të parashikuar në raport me koston e vlerësuar si të nevojshme për zbatimin e masës. Numri i punonjësve të trajnuar në administratën tatimore dhe doganore. Numri i vendeve vakante të plotësuara në administratën tatimore.	Sigurimi i një administrate tatimore dhe doganore me staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar; Rritja e profesionalizmit dhe ekspertizës së punonjësve përmes trajnimeve të vazhdueshme; Përmirësimi i kushteve të punës dhe incentiveve për të reduktuar largimet nga administrata, tërhequr specialistë të kualifikuar dhe minimizuar mundësitë për korrupsion.
	Administrata doganore	VI.15. Intensifikimi i luftës kundër kontrabandës së mallrave të paligjshme, korrupsionit dhe produkteve të falsifikuara, duke forcur kapacitetin administrativ dhe përmirësuar bashkëpunimin mes institucioneve të ndryshme të përfshira.	Në vazhdimësi	Veprimtari monitoruese	Vjetore/periodike	Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat), DPD-JA	Ministria përgjegjëse për financat, Policia e Shtetit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Drejtoria e Markave dhe Patentave, Prokuroria, Autoriteti Portual dhe Aviacioni Civil	Organizatrat ndërkombëtare	Përqindja e buxhetit të parashikuar në raport me koston e vlerësuar si të nevojshme për zbatimin e masës. Numri i rasteve të bashkënduara ndërmjet institucioneve. Numri i punonjësve të trajnuar dhe të kualifikuar për të luftuar kontrabandën dhe korrupsionin. Sistemi i analizës së riskut dhe Modulli të Selektivitetit i përmirësuar. Niveli i integritetit dhe përdorimit të skanerëve të avancuar dhe teknologjive të inteligjencës artificiale në kontrollet doganore.	Rritja e efikasitetit në luftën kundër kontrabandës, korrupsionit dhe produkteve të falsifikuara, duke siguruar bashkëpunim të përmirësuar midis institucioneve të përfshira dhe forcimit të kapaciteteve; Përmirësimi i sistemit të analizës së riskut dhe Modullit të Selektivitetit; Përdorimi i teknologjive të avancuara, përfshirë skanerët e avancuar dhe inteligjencën artificiale.
		VI.16. Harmonizimi i kuadrit ligjor me zhvillimet e reja të legjislacionit doganor të BE-së, duke u fokusuar veçanërisht në aktet zbatuese të Kodit Doganor të BE-së dhe në format e reja të deklarimit të vlerave monetare në treg.	3-mujori i katërt 2025	Veprimtari legislative dhe rregulatore, dëgjesa publike me grupet e interesit	Vjetore/periodike	Këshilli i Ministrave, Kuvendi (Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Komisioni përgjegjës për Çështjet Europiane)	Ministria përgjegjëse për Financat, DPD-ja	Organizata ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile, grupet e biznesit, bota akademike, ekspertë	Legjislacioni doganor i harmonizuar plotësisht me Kodin Doganor dhe aktet zbatuese të Kodit Doganor të BE-së. Numri i akteve të reja të miratuara /përmirësuara.	Harmonizimi i kuadrit ligjor doganor me standardet dhe kërkesat e legjislacionit të Bashkimit European.
